



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.11, datë 25/07/2022

PËR

**KORRIGJIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.SERIE 0054, DATË 22.09.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN
NR.6, DATË 22.09.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR
NËNTOKËSOR, SUBJEKTIT “KOVACI-3” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0054, datë 22.09.2017 miratuar me Vendimin Nr.6, datë 22.09.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Nga: X= 472446; Y= 4618223; Z= 3 m.m.n.d

Në : X= 471006; Y= 4622819; Z= 3 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.3 l/s

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0054, datë 22.09.2017 miratuar me Vendimin Nr.6, datë 22.09.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat, “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë teknologjik (përpunim mermeri)”, sipas koordinatave të mësipërme të korigjuara.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

